



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/560

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Belincë

E hënë, më 19 qershori 2023

Kohëzgjatja e takimit: 16:45 –18:00

Vendi i takimit: SHMFU "Emin Duraku"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike - Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar dhe njëherit ka svaruar rëndësinë e këtij takimi. Gjatë fjalimit, z. Ademi dha informata shtesë për banorët e fshatit Belincë sa i përket buxhetit të ndarë nga Komuna dhe në të njëjtën kohë kërkoi nga banorët që kërkesat e tyre t'i parashtrojnë dhe ato të cilat janë më primare për ta të vendosen në buxhetin e vitit 2024.

Pas z. Ademi fjalën e mori Drejtori i Planifikimit Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini, i cili e plotësoi më tej Kryesuesin duke dhënë informata më të hollësishme për banorët e këtij fshati.

Grejtalb Emini foli për investimet dhe projektet që janë bërë deri tani në fshatin Belincë dhe ato të cilat do të bëhen; ai kërkoi nga banorët që t'i vendosin prioritetet e tyre shembull siç janë: kanalizimi, ndriqimi, asfalti, trotuaret. Sa i përket këtij viti buxheti i ndarë është 45.000 euro, ndërsa në vitin e ardhshëm për fshatin Belincë nga investimet kapitale, i kemi të ndara 65.000 euro. Drejtori Emini tregoi që takimi i sotëm po mbahet me qëllim të marrjes së kërkeseve të banorëve dhe së bashku të vendosim për realizimin e tyre.

Kërkesat e banorëve të Shtimes:

- **Gazmend Bajrami:** Terren sportiv në brendësi të fshatit (te shkolla e vjetër);
- Rrugë e arave tek Lugu i Bajrakut dhe trotuari ka mbetur në gjysëm tek rruga kryesore dhe duhet të rregullohet;

- Të marrim pëlqim për rrëzimin e shkollës së vjetër për arsyen qytetarët nuk e dinë a është pronë private apo komunale;
- Dy shakta të pambuluara tek shtëpia e Gazmend Bajramit dhe dy të tjera afér;
- Ilir Emini: Të rregullohet kanalizimi i cili ka mbetur në gjysëm për 150 ose 200 metra, tek rruga “Pojati”;
- Nait Shatmani: Dy shakta kulluese tek rruga kryesore tek varrezat;
- Safet Brahimi: Të hapet një kanal në rrugën “Nesret Abazi”, kanal për ujërakullues, shtëpia nr. 47;
- Të rregullohet ndriqimi në tërë fshatin Belincë (nga shkolla rruga “Afrim Musliu”);
- Aziz Emini: Tek rruga ku gjendet lapidari dhe tokat tona të hapen rrugët e vjetra siç ka qenë rruga e vjetër, të cilën e ka blerë Muhameti por nuk e ka shpronësuar.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve

19.06.2023

Data: BELINCI

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	Safet Brahimu	SBM
2	GJAZMEN Bajri	Bajri
3	Jlloj Emiri	Jlloj Emiri
4	Aziz Emiri	Aziz
5	NAID Sulejmani	
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		